



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7205 Nr. i faq/Br.str/No.pg 23
Data/Datum/Date 10 / 4 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

PROCESVERBAL I RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E NDERTIMIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Konsultimi publik do të mbahet me 10.4.2026, e premte, në Sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec, me fillim në orën 10:00.

Rregullorja ka qenë në konsultim publik nga data: 1.4.2026 deri më datë: 16.4.2026

Pjesëmarrës ishin 13 persona, 12 meshkuj dhe 1 femër, dëshmi listat e nënshkrimit.

Pjesëmarrësit:

- Përfaqësues të komunës
- Qytetarë dhe palë të interesuara

Diskutimet dhe komentet

1. Edmond Avdyli, Mrasor- Pyetje lidhur për ndërrimin e destinimit të tokës.
2. Kryetari i fshatit Mrasor– Pyetje për ndryshimin e destinimit të pronave nga bujqësore në ndërtimore.
3. Perparim Krasniqi – Pyetje nëse janë të përcaktuara zonat e veçanta të ndërtimit dhe cilat zona përfshihen në zonën e 4.
4. Ramadan Gashi:
 - Pyetje për ekzistimin e planit rregullues dhe koeficientit të ndërtimit për zonat e caktuara.
 - Propozim për partneritet publik-privat për zhvillimin e qytetit të Rahovecit.
 - Pyetje për parcelën 33 ari në qendër të qytetit dhe kërkesë për rishqyrtim të marrëveshjes.
 - Kërkesë për revidim të marrëveshjes për qendrën e qytetit, mundësinë e realizimit të kërkesës së tij në kuvend dhe në DU për ndërtim të qendrës së qytetit.

ALBNOR MULLABAZI:

1. Për z. Edmond Avdyli, Mrasor – Pyetje lidhur për ndërrimin e destinimit të tokës

Drejtorja e Urbanizmit informon se ndërrimi i destinimit të tokës bëhet në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit. Çdo kërkesë trajtohet individualisht dhe duhet të kalojë në procedurat ligjore përkatëse, përfshirë shqyrtimin teknik dhe miratimin nga organet kompetente komunale. Aplikimi mund të bëhet pranë Drejtorisë së Urbanizmit, duke bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm.

2. Për Kryetarin e fshatit Mrasor – Pyetje për ndryshimin e destinimit të pronave nga bujqësore në ndërtimore

Ndryshimi i destinimit nga tokë bujqësore në ndërtimore është i mundur vetëm nëse parashihet me dokumentet planifikuese në fuqi. Në rastet kur nuk është i paraparë, kërkohet inicimi i procedurës për ndryshim të planit, e cila përfshin konsultim publik dhe miratim nga Kuvendi Komunal. Prioritet i jepet ruajtjes së tokës bujqësore sipas legjislacionit në fuqi.

3. Për z. Përparim Krasniqi – Pyetje për zonat e veçanta të ndërtimit dhe Zonën 4

Drejtorja konfirmon se zonat e ndërtimit janë të përcaktuara në dokumentet planifikuese të komunës. Zona 4 përfshin zona të caktuara me karakteristika specifike zhvillimi, të cilat janë të detajuara në Hartën

